



Republika e Kosovës



Komuna e Istogut

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË PËR FURNIZIM

(ME NJE OPERATOR)

KOMUNA E ISTOGUT, Njesia e Prokurimit te cilën e përfaqëson Menaxheri-ja e Prokurimit z. Gëzim Ademaj, Adresa Rruga "Fadil Ferati" nr 121. Me nr. tel 038 200 43 858, ne cilësinë e porositesit te sherbimeve të Autoritetit Kontraktues në njëren anë;

dhe

KONSORCIUMI "SHOSHANI" shpk & NT "CHARLY" me Nr. Rexhistrimit te biznesit: 811297458 dhe 811296004 të ciin e përfaqëson Lideri-ja I grupit z-nja Zike Idrizaj ne vazhdim "Furnizuesi", ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për furnizimet si me poshtë:

FURNIZIMI I INSTITUCIONET KOMUNALE ME LËNDË DJEGËSE DRU- ahu

Nr. I prokurimit	633-020-5042-1-1-1/FA067
Nr. I brendshëm	633 / 020 / 068 / 111

Neni 1 Lënda

Lënda e kontrate publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzimin e mallrave në vijim:

FURNIZIMI I INSTITUCIONET KOMUNALE ME LËNDË DJEGËSE DRU-

Autoriteti Kontraktues bënë blerjen vetëm në emër të vetë Autoritetit]

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuar, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin: 1.1 është (janë) të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë mallëra; të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me NENSHKRIMIN E SAJË PERKATSISHT ME DATË 28.10.2020 DHE DO TE PERFUNDOJË ME SE LARTI DERI ME 28.10. 2021 PASI KONTRAKTORI TE DESHMOJE SIGURINË PER EKZEKUTIMIN E KONTRATËS ME VLEFSHMERI PREJ 13 MUAJVE, NGA DATA E NENSHKRIMIT TE KONTRATËS.

Neni 2 Kushtet e dërgesës:

2.1 Afati kohor për dorëzim dhe kryerjen e te gjitha FURNIZIMEVE do të jetë: 28.10.2021.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jenë KOMUNA E ISTOGUT – INSTITUCIONET ARSIMORE, SHENDETËSORE DHE KOMUNALE.

2.3 Inkotermi I zbatueshëm do të jetë DDP1 (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Origjina:

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi:

4.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Furnizuesi I dates: 25.09.2020

4.2 Çmimet per njësi janë fikse dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë kornizë

Vlera totale e kontratës është: 111.720,00 Euro.

Dhe me shkronja: /Njëçindenjëmbëdhjetëmijëeshtatëçindenjëzeteuro/

4.3 Ky çmim mund të ndryshojë sipas: (Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr.

05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, neni 38 paragrafi 2, lejon devijim +/- 30% e vleres se kontrates) po qe se per këtë paraqitet nevoja nga Autoriteti Kontraktues.

Ndërsa se urdherblerjet kalojne sasine totale te kontrates publike kornizë (duke perfshirë + 30%), pa marre parasysh datën origjinale te nënshkrimit, e njëjta shkëputet automatikisht.

4.5 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Kontrata Publike Kornizë;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Lista e Çmimeve);

Urdhër blerja;

Plani per menaxhimin e kontrates

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tijë.

6.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin

Për Autoritetin Kontraktues:

KOMUNA E ISTOGUT

Për Kontraktuesin:

"SHOSHANI" SHPK & NT "CARLY"



Emri:	Gëzim Ademaj	Emri:	Zike Idrizaj
Pozita:	U.D. Menaxher-it të Prokurimit	Pozita:	L i d e r
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	28.10.2020	Data:	28.10.2020
Vula:		Vula:	

PJESA III E KONTRATES: kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe dhe gjuha serbe
Siguria e ekzekutimit	8.1	<i>Vlera e sigurisë së ekzekutimit 10 % e vlerës së kontratës, për periudhën prej 13 muaj.</i>
Cilësia e furnizimeve	16.2	<i>Autoriteti Kontraktues do t'ia bëjë pagesat operatorit ekonomik pas furnizimeve dhe pas konfirmimit nga Menaxheri i kontratës se furnizimeve janë kryer në pajtim me kërkesat në Dosje të Tenderit dhe në pajtim me kushtet e parapara në kontratë.</i>
Dorëzimi	19.3	<i>Dorëzimi i furnizimeve duhet të bëhet sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.2	<i>Mosmarrëveshjet do të provohen të zgjidhen në mënyrë miqësore. Nëse kjo nuk është e mundur, atëherë lënda do të kalojë në gjykatën kompetente siç është paraparë në pikën vijuese: 30.1.</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	30.1	<i>Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve e cila mund të lind gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate, nëse nuk është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore, lënda do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në pajtim me ligjin në Kosovë.</i>

**PARAMASA DHE PARALLOGARIA: FURNIZIMI I INSTITUCIONEVE
KOMUNALE ME LENDE DJEGESE-DRU AHU**

	Njësia	Sasia	Çmimi (€)	Shuma(€)
Blerja, furnizimi, liferimi dhe sharritja e lendes djegese - dru ah	m ²	2800	39.90 €	111,720.00 €
TOTALI ME TVSH:				111,720.00 €
<p>Drutë duhet të jene te cileses se mire, te njoma, shendosha dhe diametri minimal i drurit te jete 20cm.</p> <p>Liferimi behet nga kompania fituese e tenderi, e ne vendin ku shkarkohen drute, duhet te palosen ne metra katror, matja behet ne prezencen e personit(zyrtarit) pergjegjs te DKA apo Komunes, institucionit shkollor dhe nje tjetër, te cilet e bejn edhe pranimin e mallit.</p> <p>Palosja ne m2 ne oborret e institucioneve dhe sharritja-gjatsia, sipas kerkesave te institucionit duhet te kryhet nga kompania fituese e tenderit - ate ne afat te menjehershëm pas bartjes se druve.</p>				
***METODA E MATJES IM * IM * IM (metër hapësirë)				



